

# EKUIVALENTIMI I LICENCËS PROFESIONALE PËR INDIVIDË QË DISPONOJNË LICENCË PROFESIONALE NË VENDIN E ORIGJINËS (JO SHQIPËRI)

## DOKUMENTET PËR APLIKIM

- a) kërkesën e individit, ku të përcaktohen, të paktën, gjeneralitetet, adresa e plotë e individit, fusha dhe shkalla që mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;
- b) dokumentin e identitetit që disponon;
- c) dy fotografi 3x4 cm të vlerësuesit;
- ç) diplomën që disponon në vendin e origjinës, të legalizuar, sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- d) certifikatën për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, për fushën/at ku kërkon të licencohet, të lëshuar në vendin e origjinës, të legalizuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- dh) licencën (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv) që disponon në vendin e origjinës, të legalizuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës /apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- e) listën e objekteve të vlerësuara;
- ë) referenca nga subjekte të ndryshme, në lidhje me veprimtarinë e ushtruar në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme (të përkthyer);
- f) kopje të raporteve të vlerësimit, të përkthyer në gjuhën shqipe, nga të cilat të jenë hequr të gjitha elementet që përfshijnë të dhëna konfidenciale apo të dhëna të tjera, që përbëjnë shkelje të kontratave apo kodeve të etikës (jo më pak se 3 raporte në vit, për të paktën 2 vjet eksperience, dhe në lidhje me fushën/at për të cilat kërkon licencën e ekuivalentuar), në rastin kur kërkon të ekuivalentohet licenca e shkallës së parë;
- g) vetëdeklarim, ku individit të deklarojë se njeh dhe angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojë se nuk është i dënues nga organet e gjyqësorit, në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit (sipas lidhjes nr. 3);
- gj) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes 1).

## Dorëzimi, pranimi i aplikimit

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
2. Dokumentet për licencë duhet të jenë:
  - a) origjinale ose fotokopje të noterizuara;
  - b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;
  - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostillimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
3. PAGESA E TARIFËS PËR PËRFITIMIN E LICENCËS kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili shkarkohet nga portali ose mund të disponohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë së Zhvillimit Urban.

## Kushtet paraprake për fushat e vlerësimit

1. Individit apo vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të pajiset me licencë si **vlerësues i ndërtesave dhe tokës truall**, duhet të:
  - a) jetë diplomuar pas kryerjes së studimeve universitare të ciklit të dytë "Master" (ose ekuivalentë të këtij cikli), në degët e inxhinierisë, arkitekturës ose ekonomisë;
  - b) disponojë certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar pasuniversitar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme për ndërtesat dhe tokën truall, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara, sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, për kryerjen e këtyre programeve, të konfirmuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, ose të ketë kryer njohjen zyrtare të certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
  - c) plotësojë kushtet dhe kriteret specifike të kësaj rregulloreje.
2. Individit apo vlerësuesi i shoqërisë që kërkon të pajiset me licencë si **vlerësues i tokës bujqësore, i tokës pyjore, i tokës kullotë, i tokës livadh dhe i tokës së pafrutshme**, duhet të:
  - a) jetë diplomuar pas kryerjes së studimeve universitare të ciklit të dytë "Master" (ose ekuivalentë të këtij cikli) në degët: "Inxhinieri agrare", "Inxhinieri agromjedi", "Inxhinieri pyjesh", "Inxhinieri përpunim druri", "Ekonomi dhe Agrobiznes", si dhe në degët e inxhinierisë, arkitekturës ose ekonomisë;
  - b) disponojë certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme për tokë bujqësore, tokë pyjore, tokë kullotë, tokë livadh dhe tokë të pafrutshme, të lëshuar nga institucionet e licencuara, sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, për kryerjen e këtyre programeve, të konfirmuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, ose të ketë kryer njohjen zyrtare të certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
  - c) plotësojë kushtet dhe kriteret specifike të kësaj rregulloreje.
3. Individit apo vlerësuesi i shoqërisë që kërkon të pajiset me licencë si **vlerësues i linjave teknologjike, makinerive e pajisjeve**, duhet të:
  - a) jetë diplomuar pas kryerjes së studimeve universitare të ciklit të dytë "Master" (ose ekuivalentë të këtij cikli) në degët e inxhinierisë mekanike, elektrike, apo elektronike/profilli telekomunikacion;
  - b) disponojë certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar për vlerësimin e linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve, të lëshuar nga institucionet e licencuara, sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, për kryerjen e këtyre programeve, të konfirmuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, ose të ketë kryer njohjen zyrtare të certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
  - c) plotësojë kushtet dhe kriteret e tjera specifike të kësaj rregulloreje.
4. Individit, vlerësuesi i shoqërisë dhe shoqëria, në rastin e plotësimit të kriterëve respektive, mund të përfitojnë licencë dhe të ushtrojnë veprimtari vlerësimi në një apo më shumë nga fushat e mësipërme.

## Kushtet paraprake për shkallët e licencës

1. Licenca ekuivalentohet si licencë e shkallës së parë fitohet kur individit ka një eksperiencë profesionale jo më pak se dy vjet nga pajisja me licencë në vendin e origjinës, mbështetur në veprimtarinë e kryer në këtë fushë, të dokumentuar me referenca nga subjekte të ndryshme në lidhje me veprimtarinë e ushtruar në këtë fushë, dhe kopje të tri raporteve, për çdo vit eksperiencë (në formën e kërkuar në rregullore).

## Kushte të tjera paraprake e kufizime

1. Individit/shoqëria/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të plotësojë kushtin që të mos jetë i dënues nga organet gjyqësore për çështje që kanë lidhje me ushtrimin e aktivitetit profesional si vlerësues dhe të mos jetë në periudhën e ekzekutimit të një mase administrative të mëparshme, kundrejt licencës profesionale për vlerësim.
2. Individit/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të njohë dhe të angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e këtij profesioni dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit.